

VENDIM
Nr. 233, datë 23.4.2025

**MBI PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË MAGJISTRATËVE
(GYQTARË) NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 61, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitin 2025”, vendimit nr. 15, datë 21.1.2025, “Mbi miratimin e detajimit të punonjësve shtesë për vitin 2025, për sistemin gjyqësor,” të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vendimit nr. 585, datë 9.10.2024, “Për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit dhe rritjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të përgjithshëm të magjistratëve (gjyqtarë), në Republikën e Shqipërisë, në 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë) magjistratë (gjyqtarë).

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, Departamenti i Shërbimeve Juridike, Integritetit Evropian dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe IT, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe gjykatat e të tri niveleve.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ilir Rusi